



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SHITES PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Shtimes*, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqëse e ekipit *Sabile Musa* dhe Anëtare të ekipit *Besa Morina* dhe *Aida Podrimaj*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	26
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Shtimes për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi ynë është fokusuar në:



Konkluzionet

Konkluzioni për Pasqyrat Financiare Vjetore - Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur në pajtim me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin - Komuna në përgjithësi kishte kontrole të mira në raport me obligimet statutores. Megjithatë ekzistojnë disa dobësi të cilat duhet të adresohen. Sfidë për Komunën edhe më tutje mbetet menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i bashkëfinancimeve, pagesat me vendim gjykate, prokurimi, menaxhimi i Llogarive të Arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurive. Kjo reflekton kryesisht ndikimin nga faktorët e jashtëm.

Konkluzioni në lidhje me rekomandimet e mëhershme - Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2019 ka arritur progres të theksuar, duke marrë parasysh që disa rekomandime janë zbatuar dhe një pjesë e tyre janë në proces të zbatimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i Pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Shtimes, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë, dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Shtimes, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi kishte kontrolle të mira në raport me obligimet statutores. Megjithatë ekzistojnë disa dobësi të cilat duhet të adresohen. Edhe më tutje mbetet sfida menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i bashkëfinancimeve, pagesat me vendime gjykate/përmbartimore, prokurimi, menaxhimi i Llogarive të Arkëtueshme dhe pasurive. Kjo reflekton kryesisht ndikimin nga faktorët e jashtëm.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,642,985	9,855,018	8,477,293	86	7,360,445	6,277,581
Granti i Qeverisë –Buxheti	6,682,837	6,682,837	6,424,641	96	6,817,757	5,710,763
Të bartura nga viti paraprak ³ –		158,438	135,564	86	145,258	81,198
Të hyrat vetjake ⁴	503,882	503,882	315,984	63	264,692	379,008
Donacionet e jashtme		125,283	121,787	97	128,787	106,612
Financimi nga Huamarrja	71,266	10,266	9,026	88	3,951	
Klauzola e Investimeve	2,385,000	2,385,000	1,471,012	62	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 222,720€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak dhe donacioneve të jashtme. Ndërsa kishte zvogëlim të financimit nga huamarrja për 61,000€.

Në vitin 2019, Komuna kishte shpenzuar 86% të buxhetit final ose 8,477,293€, me një përkeqësim prej 9% krahasuar me vitin 2018 sa i përket përqindjes, duke pasqyruar se Klauzola e Investimeve prej 2,385,000€ e ka rritur vlerën e buxhetit.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,642,985	9,865,705	8,477,293	86	7,360,445	6,277,581
Pagat dhe Mëditjet	4,211,283	4,233,283	4,137,294	98	4,054,787	3,904,629
Mallrat dhe Shërbimet	830,000	861,186	733,096	85	645,594	504,902
Shërbimet komunale	199,068	199,068	191,821	96	169,490	166,621
Subvencionet dhe Transferet	131,766	132,390	126,246	95	190,178	118,406
Investimet Kapitale	4,270,868	4,439,778	3,288,837	74	2,300,396	1,583,023

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti për Investime Kapitale ishte rritur për 168,910€, si rezultat i të hyrave dhe donacioneve. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 74%. Prej tyre 45% përfshinë Klauzola e Investimeve për financimin e projektit dyvjeçar “Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Shtime”. Ky projekt është në procedurë të realizimit sipas marrëveshjes për vitin 2019-2020. Ndërsa për pjesën tjetër niveli i ulët i realizimit për Investime Kapitale ishte kryesisht rezultat i vonësve nga njësitë kërkuese.
- Financimi nga Huamarrja ishte reduktuar për 61,000€⁵.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna gjatë vitit 2019 ishin 429,285€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Gjithashtu Komuna kishte edhe të hyra indirekte nga gjrobat e trafikut në vlerë prej 95,845€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat tatimore	207,667	207,667	173,658	84	141,231	122,420
Të hyrat jo tatimore	296,215	296,215	255,627	86	199,186	420,868
Totali	503,882	503,882	429,285	85	340,417	543,288

Nga të hyrat vetanake të planifikuara, komuna ka realizuar 85%, dhe vërehet një trend i rritjes nga viti paraprak.

⁵ Kjo shumë ka të bëjë me projektin Shëndetësia Kosovare (skema e pagesës së performancës), dhe e njëjta nuk ishte alokuar nga Ministria e Financave.

Çështja B1 – Mos barazim i të hyrave ne mes të Departamenteve dhe zyrtarit te të Hyrave

Gjetja Sipas nenit 13 (pika 3.3) e Rregullës financiare 03/2010 – Për të hyrat vetanake OB-ja, është e obliguar që ta bëjë barazimin e të hyrave në Thesar. Për tu kryer kjo drejtoritë përkatëse në komunë duhet që çdo muaj të bëjnë barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave.

Përveç regjistrimit të të hyrave vetanake si dhe harmonizimit mujor dhe tremujor në Thesar, kërkohet edhe harmonizimi i të hyrave në mes të Departamenteve dhe Zyrtarit të të Hyrave në Komunë i cili duhet të bëhet për çdo muaj.

Aktualisht gjashtë (6) drejtori komunale nuk i barazojnë të hyrat e tyre me zyrtarin e të hyrave⁶. Përkundër kërkesave dhe njoftimeve me shkrim nga ana e Zyrtarit të Hyrave ende nuk ka pasur përgjigje pozitive për realizimin e barazimeve. Kjo ka ndodhur për shkak të mos gatishmërisë dhe neglizhencës së zyrtarëve të drejtorive përkatëse të cilët përkunër rekomandimit tonë dhe planit të veprimit të komunës, nuk kanë ndërmarrë masa në këtë drejtim.

Ndikimi Mos realizimi i barazimeve mujore ne mes te drejtorive komunale me zyrtarin e te hyrave rrezikon devijime të caktuara në kontrolle të brendshme duke shkaktuar mangësi të informacionit në kohë, mbi llojet dhe shumatat e të hyrave.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.

⁶ Administrata e Përgjithshme, Shërbimet Publike, Çerdhja, Gjeodezia, Arka Inspektorati dhe Arsimi.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga dhe mëditje ishte 4,233,283€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 665 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 673. Numri aktual ishte me i larte për 8 shkakun e zëvendësimit të stafit me rastin e pushimeve të lehonave dhe pensionimit kryesisht në sektorin e arsimit. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 35 të rinj. Kemi testuar 23 mostra për teste substanciale në vlerë 17,312€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 Pagesa e zyrtarëve të AME-së në mungesë të informatave për punën e tyre

Gjetja Bazë për kompensimin e pagave dhe shtesave eventuale duhet të jetë kontrata e punës dhe dëshmitë se punonjësitë kanë punuar gjatë muajit përkatës. Komuna kishte vazhduar të kompensoj për 8 zyrtarë/zjarrëfikës, në mungesë të informatave (kontratave dhe dëshmime të punës). Kjo ka ndodhur si pasojë e asaj se këta zyrtarë, sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si punëtor të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit të gjitha kompetencat rreth menaxhimit, përfshirë menaxhimin e dosjeve të punëtorëve janë bartur nga Komuna në AME respektivisht MPB, me përjashtim të buxhetit, i cili për shkaqe të panjohura ka mbetur tek komuna. Prandaj komuna kryen vetëm kompensimin e pagave dhe shtesave nga buxheti i saj. Pagat dhe shtesat për këta punëtor gjatë vitit 2019 ishin 49,634€. Kjo çështje do të vazhdoj të përsëritet vit pas viti, derisa Ministria e Financave nuk ndërmerr hapa për bartjen e buxhetit në MPB.

Ndikimi Pagesa për zyrtarët, në mungesë të kontratave dhe raporteve mujore për angazhimin, mund të rezultojë me pamundësinë për të justifikuar pagën dhe shtesat eventuale.

Rekomandimi B2 Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkoj ngë personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhet nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.

Çështja B3 – Tejkalmi i kohëzgjatjes së kontratave për stafin e angazhuar me MShV

Gjetja Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12, pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Poashtu sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 10, paragrafi 6, përcaktohet qartë se kontratat për detyra specifike nuk mund të zgjasin më shumë se 120 ditë brenda 1 viti.

Komuna, gjatë vitit 2019 kishte angazhuar nëntë zyrtarë përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV). Pas përfundimit të kontratave 6 mujore, dy zyrtarëve iu është vazhduar kontrata edhe për tre muaj të tjerë. Edhe pse kjo është në kundërshtim me rregullat e zbatueshme, sipas zyrtarëve të komunës kjo është bërë me qëllim të arritjes së objektivave të komunës në fusha të caktuara ku janë angazhuar këta zyrtarë.

Ndikimi Angazhimi i Stafit me MShV përtej afateve të lejuara, është në kundërshtim me normat ligjore dhe tregon për planifikim jo të mirë të resurseve. Po ashtu kjo mund të shkaktojë pagesa potencialisht të parregullta.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) për vitin 2019 ishte 1,060,254€, prej tyre ishin shpenzuar 924,916€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: furnizim për zyre, furnizim me pajisje, shërbime kontraktuese tjera, shpenzime komunale, pagesa me vendim të gjykatës etj. Kemi testuar 20 mostra për teste substanciale në vlerë 140,264€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 132,390€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 126,246€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me Subvencionet për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për Kulturë Rini dhe Sport, Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 30,970 si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,439,778€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 3,288,837€. Ato kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve, ndërtim të kanalizimeve, mirëmbajtje investive, pagesa me vendim të Gjykatës etj. Kemi testuar 43 mostra për teste substanciale në vlerë 2,617,454 si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 Vonesa në realizimin e punimeve

Gjetja Bazuar në kushtet e kontratës për “Asfaltimin e Rrugëve në Muzeqinë”, të nënshkruar në tetor 2018, në vlerë 111,917€, data e përfundimit të gjitha punëve me pranim teknik do të jetë 12 muaj, nga data e fillimit të punimeve.

Te kjo kontratë kishte vonesa në realizimin e punimeve. Komisioni për pranim teknik të punëve ka konstatuar se punët nuk janë kryer me kualitetin e kërkuar, ku në disa segmente edhe pas kërkesës për intervenim nuk janë bërë përmirësimet e kërkuara. Për vonesat e shkaktuara nga OE i është ndaluar pagesa e fundit dhe nuk ka ndodhur pranimi teknik i punëve.

Përveç kësaj komuna po përballlet me mungesë të stafit adekuat për menaxher të projektit. Në shumicën e rasteve është zgjedhur menaxheri i njëjtë për kontrata të ndryshme. Për shkak të ngarkesës së madhe menaxheri i projektit nuk është siguruar me kohë se operatori ekonomik nuk i ka përmbushur të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

Ndikimi Mos përmbushja e obligimeve nga operatori ekonomik sipas kushteve të kontratës, si dhe mungesa e kuadrit për menaxher të projektit sjell vështirësi në realizimin e objektivave të komunës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurohet se për çdo dështim të operatorit ekonomik për ti korrigjuar defektet në kohë, dështimet e tilla do të rezultojnë me konfiskim të sigurisë së ekzekutimit dhe të kërkojë zhdëmtim shtesë të shkaktuar nga mospërmbushja e kontratës. Po duhet të shikohet mundësia që të plotësohet numri i stafit me kuadro adekuate për menaxher të projektit.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B4 – Pagesat me Vendime të Gjykatës/përmbarimore

Gjetja Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39 kërkon që faturat e vlefshme të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike.

Thesari përmes vendimeve gjqësore/përmbarimore kishte ekzekutuar pagesa në emër të Komunës në vlerë 55,164€, për paga jubilarë dhe përcjellëse⁷ të mësimdhënësve të pensionuar në vitet e mëhershme. Nga kjo shumë, pjesa prej 39,434€ është paguar nga Investimet Kapitale dhe 15,730€ nga mallrat e shërbimet. Shpenzimet e tilla përveq që janë bërë nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve, kanë shkaktuar edhe ngarkesë të buxhetit të komunës për shpenzimet shtesë për procedurat përmbarimore në vlerë 7,538€. Kjo ka ndodhur në mungesë të aprovimit të buxhetit për këto pagesa dhe si rezultat i mungesës së mjeteve në kategorinë e pagave, pagesa është bërë nga kategoritë tjera.

Për shpenzimet e udhëtimit me rastin e manifestimit “Ditët e Masakrës së Reçakut”, obligimi i bartur nga viti 2017 si pasojë e mos pagesës me kohë, është ekzekutuar me procedurë përmbarimore në vlerë prej 5,375€, duke dëmtuar buxhetin e komunës për shpenzimet shtesë (përmbarimore dhe të tjera) në vlerë prej 773€.

Ekzekutimi i pagesave me vendim të gjykatave në rastin e pagave ka ndodhur për shkak se për këto pagesa nuk është paraparë buxhet, derisa në rastin e dytë ka ndodhur shkak që pagesat nuk janë kryer brenda afatit ligjor për pagim të faturave.

Ndikimi Shpenzimet për paga të mësimdhënësve nuk nxjerrin në pah elemente të shpenzimeve që do të plotësojnë përkufizimin e “Kapitaleve dhe Shërbimeve”. Prandaj kjo ndikon në mbivlerësim të shpenzimeve për Investimet Kapitale dhe Mallra e Shërbime si dhe nënvlerësim të shpenzimeve për paga dhe mëditje. Ndërsa mos pagesa me kohë e faturave shakton shpenzime shtesë si rezultat i realizimit të të drejtave të përmes procedurave të përmbarimit.

⁷ Obligimi për këto pagesa ka rrjedhur si pasojë e “Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës”.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj që janë evidentuar dhe përlllogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendonjë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë për vonesa dhe shpenzime të përmbarimit.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale, e paraqitur në PFV ishte 49,476,087€, vlera e pasurive jokapitale ishte 264,320€, si dhe e stoqeve 5,739€. Kemi testuar 41 mostra për teste substanciale në vlerë 2,473,074€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 – Mungesa e Raportit të Përgjithshëm për Inventarizimin e Pasurisë

Gjetja Sipas Nenit 19.4.7 të Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, një ndër përgjegjësitë e komisionit për inventarizim është hartimi i Raportit të Përgjithshëm për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare, në kohën e përshtatshme para përgatitjes së PVF-ve. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara;

Komuna gjatë procesit të inventarizimit ka përpiluar raporte individuale të inventarizimit për pasuritë nën 1,000€ si, për departamentet e caktuara, por nuk është bërë Raport i përgjithshëm për të gjitha pasuritë jo financiare mbi të cilat komuna ushtron kontroll dhe prej të cilave ka përfitime ekonomike. Këto regjistra ishin të mangët dhe nuk janë krahasur me regjistrin kontabël të pasurive para hartimit të PFV-ve.

Kjo ka ndodhur si pasojë e vëmendjes së pa mjaftueshme e Komunës për të poseduar një dokument i cili do të pasqyroj të gjitha informatat për vlerën dhe gjendjen fizike të pasurive si dhe aktivitetet tjera të ndërmarra lidhur me pasuritë e përgjithshme.

Ndikimi Mos realizimi i plotë i inventarizimit të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultojë që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund ti ekspozohen humbjes apo tjetërsimit. Kjo mund të rezultojë në mbivlerësimin e pasurive në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A2 Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit të përfshijë të gjitha pasuritë në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.

Çështja A3 - Mos shpalosja e pasurisë/objektit të Shtëpisë së Kulturës në PFV

- Gjetja** Sipas Nenit 11 të Rregullores MF – NR. 02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë në Organizatat Buxhetore, pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.
- Objekti i Shtëpisë së Kulturës i cili ishte ndërtuar në parcelën komunale dhe financuar nga Bashkimi Evropian me vlerë 821,923€⁸, nuk është përfshirë në regjistrin e pasurive dhe nuk është shpalosur në PFV, përkundër faktit se Shtëpia e Kulturës është në funksion dhe gjeneron të hyra. Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka pranuar dokumentacionet në lidhje me investimet në këtë objekt dhe nuk është bërë ndonjë pranim dorëzim formal i objektit nga Bashkimi Evropian.
- Ndikimi** Mos përfshirja e objektit të Shtëpisë së Kulturës në regjistrin e pasurive, ndikon në cilësinë e informatave dhe nënvlerëson vlerën e pasurive në regjistër dhe në PFV.
- Rekomandimi A3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i siguruar informatat e nevojshme financiare në lidhje me projektin në mënyrë që objekti në fjalë të evidentohet në regjistrat e pasurive të komunës dhe të shpaloset në PFV.

⁸ Kjo është vlera e kontratës për ndërtimin e këtij objekti.

2.3 Të Arkëtueshmet

Në PFV-të e vitit 2019, komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 512,778€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë për objekte dhe për parcela, qiraja për shfrytëzimin e pronës publike dhe për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Çështja C1 – Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme – tatimi në pronë

Gjetja

Sipas “Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në Pronë, neni (12) par. (2). Çdo Komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Ndër të tjera komuna shqyrton dhe vendos mbi ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.

Komuna e Shtimes për vitin 2019 kishte raportuar llogari të arkëtueshme nga tatimi në prona-objekte prej 453,196€ dhe tatimin në toka prej 55,244€ ku një pjesë e madhe e borxheve të grumbulluara të tatimit në pronë prej 41,366€ i përkasin ish ndërmarrjeve shoqërore. Këto llogari të arkëtueshme janë bërë barrë aktuale vjetore e faturës së tatimit në pronë të cilat po rriten vit pas viti, dhe gjasat për vjelje të detyrueshme janë shumë të vogla ose realisht të pa inkasuara deri më tani. Sipas kontratës me AKP-n blerësi i ri i pronës shoqërore ka obligim të paguaj tatimin në pronë vetëm për 12 muaj kalendarik, kurse pjesa tjetër e borxhit paguhet gjatë procesit të likuidimit.

Po ashtu komuna nuk ka arritë t’i shqyrtojë me kohë ankesat e bëra nga pronarët e pronave të faturuara. Gjithsej janë bërë 291 ankesa dhe shumë nga to nuk janë shqyrtuar. Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e parcelave.

Bartja e obligimeve nga ish ndërmarrjet shoqërore ka mbetur në mungesë të iniciativës së përbashkët në mes të Komunës dhe AKP-së për zgjidhjen e çështjes së këtyre llogarive të arkëtueshme të vjetërsuara të cilat përcjellën edhe me ngarkesa shtesë të gjobave dhe kamatave nga ana e komunës për tatimin në pronë mbi këto llogari. Derisa ankesat në lidhje me vlerësimin e parcelave kanë ardhur nga pengesat në implementimin e Ligjit të ri për tatimin në pronë.

Ndikimi

Trendi i rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive të arkëtueshme ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të borgjeve të Komunës. Ngjashëm ndikon edhe mos shqyrtimi me kohë i ankesave të pronarëve në lidhje me vlerësimin e pronave, pasi që obligimet nuk paguhen me kohë.

Rekomandimi C1 Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-n lidhur me obligimet për NSH –të të cilat janë në menaxhimin e tyre, dhe të ish NSH-ve të privatizuara. Poashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.

Çështja A4 - Vonesa në shqyrtimin e ankesave në lidhje me tatimin në pronë

Gjetja Sipas “Ligjit nr. 06/L-005 neni 12 paragrafi 2, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Ndër të tjera komunashqyrton dhe vendos mbi ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.

Gjatë vitit në drejtim të komunës ishin drejtuar 291 ankesa, të cilat ndërlidhen kryesisht me vlerësimin jo adekuat të pronave, ndërsa shumë nga këto kërkesa kanë mbetur të pa trajtuara. Numri i madh i ankesave ka ardhur si pasojë e implementimit të Ligjit të ri për Tatimin në Pronë, metodës së vlerësimit të pronave dhe për shkak të mungesës së një analize për Raportin e përgjithshëm të vlerësimit të pronave i publikuar nga DTP.

Ndikimi Numri i madh i ankesave dhe mos shqyrtimi i tyre mund të ndikoj në vështirësi në inkasimin e te hyrave nga tatimi në pronë dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme në fundvit. Këtë situatë e rëndon edhe fakti se ankesat e parashtruara nuk e lejojnë të ndërmerren asnjë nga masat e detyrueshme derisa të merret një vendim përfundimtar mbi ankesën e personit.

Rekomandimi A4 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se Departamenti i tatimit në pronë ti shqyrtojë në kohë të arsyeshme ankesat e pronarëve në lidhje me vlerësimin e pronave. Në rastet kur është e nevojshme të bëhen korigjime të vlerësimeve, duhet të intensifikohet bashkëpunimi me MF për të zgjidhur këtë çështje.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 68,511€. Këto detyrime janë bartur për t’u paguar në vitin 2020.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 282,939€, për të cilat komuna ishte në procese gjyqësore.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Sipas informatave të siguruar nga komuna e Shtimes vlera e detyrimeve kontraktuale në fund të vitit 2019, ishte 1,544,693€.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Komuna kishte themeluar edhe Komitetin e Auditimit (KA) në përbërje prej tre anëtarëve, mirëpo nga muaji korrik 2019 është dorëhequr njëri prej anëtarëve dhe derisa ishim në auditim (maj 2020) ende nuk ishte plotësuar. Gjatë vitit 2019, KA kishte mbajtur katër takime, ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së për raportet e vitit 2019, si dhe ishte diskutuar raporti i ZKA-së për vitin 2018.

NjAB kishte hartuar Planin Vjetor të vitit 2019 si dhe Planin Strategjik për vitet 2019-2021. Sipas planit vjetor të auditimit ishin planifikuar që të kryhen gjashtë auditime, prej tyre tri auditime me rrezikshmëri të lart dhe tri auditime me rrezikshmëri të mesme. Gjatë vitit 2019 NjAB ka arritur të përmbush planin vjetor, të finalizojë gjashtë raporte të auditimit, prej tyre tri raporte fushëveprim kishin vitin 2018 ndërsa tri raportet tjera mbulonin vitin 2019. Secili raport i auditimit është përcjellë me një aneks për rishikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e NjAB.

Nga këto raporte kanë rezultuar 14 rekomandime, gjashtë prej tyre janë adresuar, katër janë në proces të zbatimit dhe katër kanë mbetur të pazbatuara.

Çështja A5 – Përbërja e Komitetit të Auditimit

Gjetja Sipas Ligjit Nr.06/L-021 mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 20.3 Komiteti i Auditimit përbëhet nga tre(3) ose pesë(5) anëtarë, ku dy të tretat (2/3) janë të jashtëm nga fusha përkatëse e auditimit, ndërsa pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik.

Komiteti i Auditimit i Komunës së Shtimes, prej korrikut 2019 përbëhet nga dy anëtarë dhe të dy anëtarët janë staf i brendshëm i komunës. Kjo ka ndodhur për shkak të vëmendjes së pamjaftueshme nga ana e kreut të komunës.

Ndikimi Anëtarët e KA të cilët janë staf i brendshëm i subjektit të sektorit publik mund të jenë subjektiv për vlerësimin e auditimit ë fushave të caktuara të kryera nga NjAB si dhe funksionimi i KA me kapacitete jo të plota rrezikon arritjen e objektivave tij.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurohet se emërimi/përbërja e anëtarëve të KA të jetë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-021 mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe udhëzimi administrativ i MF Nr.01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e KA në Sektorin Publik.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Shtimes ka rezultuar me 17 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Sipas zyrtarëve të komunës 10 rekomandime janë zbatuar, 6 janë zbatuar pjesërisht dhe 1 e pazbatuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 7 rekomandime janë zbatuar; 1 ishte në proces të zbatimit, 4 nuk janë zbatuar ende dhe 5 tjera konsiderohen si rekomandime të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.	Çështja mbetet e njëjtë (shih çështjen B1).	Rekomandim i pazbatuar
2		Kryetari duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të ngarkesës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren duke angazhuar anketues kompetent.	Vështirësitë në zbatimin e sistemit PROTAX 2 po shkaktjnë ende gabime.	Rekomandim i mbyllur
3		Kryetari duhet të siguroj se po ndërmerren aktivitete shtesë për eliminimin e dobësive dhe inicioi përditësimin e rregullores për ndarjen e duhur të këtyre zonave tatimore me gjendjen faktike në teren.	Si me lartë, shih përgjigjen nr. 2	Rekomandim i mbyllur
4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në	Çështja mbetet e njëjtë,	Rekomandim i pazbatuar

		institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeverisë në të kundërtën kompensimet e tilla nuk lejohen.	zbatimit I këtij rekomandimi nuk varet nga Komuna - buxheti për zjarrfikës duhet të menaxhohet nga Agjencinë në MPB.	(shih B2)
5		Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore/shëndetësore dhe menaxheri i personelit duhet të azhurnojnë kontratat e punës, kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtorët e shkollave të monitorojnë pushimet e stafit dhe vlerësimet e performancës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit.	Dosjet janë kompletuar, me përjashtim të disa kontratave të pa azhurnuara në arsim. Një rekomandim i ri në lidhje me këtë çështje është dhënë në Letërmenaxhment.	Rekomandim i mbyllur pjesërisht i zbatuar.
6	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plot me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.	Çështja është e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar (Shih B2)
7	Subvencionet dhe transferet	Kryetari i Komunës të siguroj kontrolle të shtuara që gjatë vlerësimit të dëmeve për programet e veçanta të subvencionimit, procesi i kriterëve të vendosura duhet të mbështetet me dëshmi përkatëse të paraparë në rregulloren dhe dispozitat në fuqi.	Nuk kemi identifikuar mungese të dëshmive për ndarjen e subvencioneve gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Duhet sigurohet se për mbikëqyrjen e projekteve janë vendosur zyrtar	Nuk kemi identifikuar lëshime teknike.	Rekomandim i zbatuar

		kompetent të cilët monitorin implementimin e kontratës dhe pranojnë vetëm punët e realizuar, nënshkruajnë situacionet sipas gjendjes faktike, në të kundërtën duhet të aplikohen masat për lëshimet e pa përgjegjshme apo neglizhente si dhe para ekzekutimit të pagesave të forcoj masat e kontrollit dhe të bëjnë barazimet e nevojshme.		
9		Kryetari i Komunës të siguroj kontrolle të shtuara në mënyrë që të bëhet vlerësim i drejtë i ofertave dhe të mos shpërblehen me kontratë operatorë të pa përgjegjshëm.	Nuk kemi identifikuar çështje pa përmbushje të kriterëve.	Rekomandim i zbatuar
10		Kryetari përmes menaxherëve të kontratës duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj Inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv dhe nuk duhet të lejohen tejkalime-ndryshime të pozicioneve të para masave paraprakisht të kontraktuara. Në të kundërtën çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës nëse paraprakisht nuk sigurohet miratimi nga organet relevante.	Kemi identifikuar një rast të kontratat për shërbime. Një rekomandim për një çështje të ngjashme është dhënë në letërmenaxhment.	Rekomandim i mbyllur.
11	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të planifikuar buxhet të mjaftueshëm krahas detyrimeve/obligimeve që pret komuna të përballet, për të ju dhënë prioritet shlyerjes së këtyre obligimeve me kohë, si dhe të prezantojë drejtë shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe natyrës reale të shpenzimeve.	Ekzistojnë pagesa të ekzekutuara me vendim gjykatë për vonesa dhe për pagat e mësimdhënësve .	Rekomandim i pa zbatuar (Shih B4)
12		Kryetari të siguroj që kontrollet janë funksionale dhe zyra e prokurimit nuk duhet të nënshkruaj asnjë kontratë publike pa zotim të mjeteve apo ndërmerr obligim në një shumë që i tejkalon fondet e ndara.	Nuk kemi identifikuar raste të nënshkrimit të kontratave pa mjete të mjaftueshme	Rekomandim i zbatuar
13	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se procesi gjithë	E-pasuria është	Rekomandim

	kapitale dhe jo-kapitale	përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatitë një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi, të siguroj një evidencë të saktë të inventarit, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-Pasuria dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.	vënë në funksion dhe pasuria është regjistruar, me përjashtim të një rasti specifik.	i zbatuar
14	Të Arkëtueshme t	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	U janë dërguar vërejtje debitorëve të cilët nuk i kane përmbush obligimet.	Rekomandim në proces të zbatimit (shih C1)
15	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që faturat protokollohet me rastin e pranimit dhe paguhet brenda afatit ligjor.	Ekzistojnë vonesa në realizimin e pagesave të cilat janë ekzekutuar nga Thesari me Vendim të Gjykatës.	Rekomandim i mbyllur (Një pjesë e rekomandimit është bartur tek rekomandimi B4)
16	Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, kryetari duhet të rishikojë kapacitetin e resurseve njerëzore brenda NjAB-dhe nëse vlerëson se nevojitet angazhimi i stafit shtesë, atëherë duhet të krijohen mundësitë edhe për angazhime të reja. Duhet të sigurohet se rekomandimet e dhëna nga NjAB janë duke u konsideruar	Stafi është kompletuar.	Rekomandim i zbatuar

		seriozisht dhe zbatuar nga divizionet/ personat përgjegjës.		
17	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.	Aplikohet raportim i rregullt dhe është përgatitur regjistri i rreziqeve.	Rekomandim i zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.		
2	Paga dhe mëditje	Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkoj ngë personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.		
3		Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.		
4	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se për çdo dështim të operatorit ekonomik për ti korrigjuar defektet në kohë, dështimet e tilla do të rezultojnë me konfiskim të sigurisë së ekzekutimit dhe të kërkojë zhdëmtim shtesë të shkaktuar nga mospërmbushja e kontratës. Po duhet të shikohet mundësia që të plotësohet numri i stafit me kuadro adekuate për menaxher të projektit.		
5	Çështjet e përbashkëta për M&Sh dhe IK	Kryetari duhet të siguroj që janë evidentuar dhe përlllogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendonjë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë për vonesa dhe shpenzime të përmbarimit.		
6	Pasuritë kapitale dhe	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit të përfshijë të gjitha pasuritë në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me		

	Jo kapitale	regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.
7		Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për tu siguruar informatat e nevojshme financiare në lidhje me projektin në mënyrë që objekti në fjalë të evidentohet në regjistrat e pasurive të komunës dhe të shpaloset në PFV.
8	Të arkëtueshmet	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-n lidhur me obligimet për NSH –të të cilat janë në menaxhimin e tyre, dhe të ish NSH-ve të privatizuara. Poashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/ A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.
9		Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se Departamenti i tatimit në pronë ti shqyrtojë në kohë të arsyeshme ankesat e pronarëve në lidhje me vlerësimin e pronave. Në rastet kur është e nevojshme të bëhen korigjime të vlerësimeve duhet të shtohet bashkëpunimi me MF për të zgjidhur këtë çështje
10	Funksionimi i Auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurohet se emërimi /përbërja e anëtarëve të KA të jetë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-021 mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe udhëzimi administrativ i MF Nr.01/2019 për Themelimin dhe Funksionin e KA në Sektorin Publik.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit. Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtimes, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Naim Ismajli

Kryetar i Komunës së Shtimes,

Data: 21.korrik.2020, Shtime,

